ENKELEJDA KONDI-MASSEBOEUF

UNË DHE TË TJERËT

REFLEKSIONE MBI JETËN, ARTIN DHE SHOQËRINË

BOTIMET TOENA

ENKELEJDA KONDI-MASSEBOEUF

UNË DHE TË TJERËT

REFLEKSIONE MBI JETËN, ARTIN DHE SHOQËRINË

BOTIMET TOENA
Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Eris Rusi
Përkujdesja grafike: Klevisa Çela

ISBN 9789928961112

©AUTORJA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMETTOENA
Rr. "M. Gjollesha", nr. 71, Tiranë 1023
ose K. Postare 1420
Tel.: +355 67 70 70 884
botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
https://toena.al

Përmbajtja e lëndës

HYRJE 9

KAPITULLI I
KUJTESË DHE FËMIJËRI 13

Bora e fëmijërisë 13
Kujtim vjeshte 16
Në shi 19
Mëngjes tetori 21
Mëngjes dhjetori 23
Unë dhe bora 29
Dita e parë e shkollës 33
Në prag të fundit të vitit shkollor… 35
Fundjavë 38
Kur kujtesa ulet për kafe 40
Vallëzim mes reve 43
Frymëzim momenti 45
Edhe atëherë bëheshin hile… 47
Pse fëmijët vizatojnë gjithmonë të rriturit me një zemër? 49
Një jetë mes fëmijëve, një profesion me shpirt 51
Nuk ka fëmijë të vështirë 55
Kur je larg 58

KAPITULLI II
EMIGRACIONI DHE ATDHEU 58

"Le manque du pays" (Mungesa e atdheut) 62
Të gjesh vendin tënd në një shoqëri që ka mësuar të jetojë pa ty 67
Një Shqipëri që lulëzon, por një zemër që s'di ku t'i zërë rrënjët … 71
Diskriminimi ndaj diasporës dhe reflektimi mbi identitetin kombëtar 74
Emigracioni në masë: kriza e përfitimeve sociale 78
Edhe emigranti do të votojë! 82
Largohemi prej vetes, kur mundohemi t'ju ngjajmë të tjerëve! 86
Gjysmë jete e dy rrugëtime 88

18 Dhjetori, dita kombëtare e Diasporës.....92
Letërsia e emigracionit dhe e emigrantëve.....95
Fluturimet me avion 99
Mirë se vjen në shtëpi, bija ime!.....101
Nuk ka vdekur poezia, por letërsia po lëngon! 103

KAPITULLI III
LETËRSIA, POEZIA DHE LIBRI 103

Poezia në kohërat moderne: Lufta për të mbetur "gjallë" 109
Poezia nuk është status Facebook-u 112
Lexuesi e mban gjallë poezinë 114
Poezia në hijen e çmimeve të Panairit: një art pa trofe.....116
Shumë poetë, shumë poezi, por shumë pak tekste për këngë të bukura 120
Kur poezia provokon 123
Lexuesi shqiptar dhe kufijtë e shijes në letërsi.....126
Kur lexuesi paragjykon poetin.....128
Ai që nuk lexon, është i destinuar të besojë gjithçka.....130
Mos u mburrni me librat që keni lexuar! 134
Libri në formatin e xhepit: Një dritare praktike drejt botës së leximit.....136
Titujt e librave duhet të jenë të mbrojtur me të drejtë autori.....140
Tregu i librit: Një formë e re censure?.....143
Botimet, botuesit dhe autorët: Një pasqyrë e realitetit të librit me poezi
në veçanti dhe librit në përgjithësi në Shqipëri 145
Diskriminimi letrar: Sfida e autorëve të rinj dhe komercializimi i
botimeve në Shqipëri 148
Një thirrje për vlerësimin e autorëve të rinj.....153
Kur botuesi zbret nga piedestali dhe bëhet "shoku ynë i leximit" 155
"Loti është grua": poezia si ndjenjë, përkthimi si urë mes gjuhëve.....159
Muzika, pasqyrë e shpirtit.....163
A është arti sot pa emocion, apo ne kemi ndryshuar mënyrën si
ndiejmë?.....168
Rilindja e artit në kohë trazirash: nga karantina te historia botërore 171
Forca e shpirtit krijues.....174
Tetori, muaji i letërsisë 177
Festa e librit dhe festa e Sant Jordi-t.....179

Refleksion pas Panairit të Librit 184
Një derë që hapej drejt poezisë 186
Poetët dhe kafshët e tyre: një miqësi e heshtur 189
Në kujtim të një ndalesë poetike me Skënder Rusin dhe Vangjush Zikon 192
Ditët e Letërsisë Shqipe në Miçigan 195
Mbresa dhe kujtime të paharruara nga promovimi i librit tim me poezi "Botën ta prek", në Miçigan. 198
Një ditë e paharrueshme në gjimnazin "Qemal Stafa" në Tiranë 203
Një udhëtim në zemrën e historisë franceze 207
Kruja, qyteti i krenarisë shqiptare 209
Simone Veil, një figurë e jashtëzakonshme franceze në historinë moderne të Evropës 212
Libri "Çdo grua duhet të bëjë plane" 215
Dje heshtnim, sot flasim 218

KAPITULLI IV
SHOQËRIA SHQIPTARE DHE AKTUALITETI 218

Kur komentet shndërrohen në armë: Dhuna verbale në rrjetet sociale ... 223
Shoqëria e negativitetit. Kur bëhemi sfungjer emocional 226
Bullizimi tek fëmijët dhe të rinjtë: një plagë sociale e cila kërkon vëmendje urgjente 234
Dhuna në mosha të reja: çfarë po ndodh me rininë tonë? 239
Kronika e zezë në Televizionin Shqiptar: Efektet negative në shëndetin mendor të shoqërisë 242
Spektakli i jetës private në televizione 247
Programet televizive "Reality Show": argëtim apo degjenerim kulturor?! 250
Kultura otomane-arabe në Shqipëri, mjerimi që na la pas! 253
Aktualitet 257
Shqipëria, një vend i vogël me një xhelozi të madhe 259
Festat, bashkëjetesa dhe sfidat e kohëve moderne 263
Tavolinat plot, shpirtrat bosh! 267
Festivali i Këngës: traditë, keqkuptime dhe një rrugë e gabuar drejt Eurovizionit 269
Festivali i Këngës në RTSH, nga një festë në një garë 273

Pse nuk e ndjek më Eurovizionin....276
Ku ka shkuar "Hiti i verës"?....278
Hekurudhat në Shqipëri....281
Profesori i qytetit të vogël....283
Dija atëherë dhe sot....286
Intelektuali i vërtetë dhe iluzioni i VIP-it....289
Sytë dashurohen para zemrës!....293
A ka sot vend bota për shpirtrat e ndjeshëm?....295
La boîte à livres (Kutia e librave)....297
Qentë endacakë....300
Ata që kanë më pak, japin më shumë....303
Ne mund të zgjedhim miqtë, por jo familjen....305
Shoqëria jonë, në kërkim të paqes së humbur!....309
"Jemi mësuar të maskohemi aq shumë përpara të tjerëve, saqë maskohemi edhe përpara vetes sonë." François de La Rochefoucauld ...311

KAPITULLI V
REFLEKTIME FILOZOFIKE DHE NJERËZORE....311

Urtësia e vërtetë: Hesht dhe shiko....316
Njeriu sheh, dëgjon dhe flet. Fatkeqësisht sot njeriu sheh keq, dëgjon pak dhe flet shumë!....318
Askush nuk urrehet më shumë se ai që thotë të vërtetën (Platoni)....322
"Buzëqesh dhe lëre qiellin të të hyjë në zemër." Victor Hugo....325
Humbjet si etapa të detyruara drejt suksesit....330
Zjarr, dhimbje dhe humbje....333
Pas 8 Marsit....335
Liria e mendimit në kohë zgjedhjesh: Një reflektim për shoqërinë tonë..339
Forca e shpirtit krijues....342

EPILOG....345

HYRJE

Deri më tani, lexuesi më ka njohur nëpërmjet poezisë. Aty kam gjetur zërin tim për vite me radhë, kam pasqyruar përjetimet, ndjesitë më intime, refleksionet mbi botën dhe jetën, në tetë ndalesa të ndryshme që janë tetë vëllime të botuara me poezi. Kësaj here kam ardhur me një libër ndryshe, më i drejtpërdrejtë, më reflektues, ndoshta më i zhveshur nga metafora, por po aq i sinqertë. Ky libër lindi ngadalë, pa zhurmë, në biseda të thjeshta, por që depërtojnë në brendësi të natyrës njerëzore. Lindi mes reflektimeve të përditshme, mes vëzhgimeve mbi sjelljet e njerëzve, mbi shoqërinë, ngjarjet historike dhe lëvizjet që e trazojnë apo e formësojnë

atë. "Unë dhe të tjerët" është një përpjekje për të kuptuar veten përmes të tjerëve dhe të tjerët përmes vetes.

Shumë nga këto shkrime kanë fillesën në bisedat me babain tim. Reagimet e mia ndaj realitetit, ndaj padrejtësive, ndryshimeve shoqërore apo sjelljeve njerëzore, shpesh shoqëroheshin me fjalët e tij të thjeshta, por të forta: "Shkruaji. Mos i lër të humbasin. Mblidhi."

Këto fjalë u bënë një shtysë, një përgjegjësi morale për të mos i lënë mendimet të mbeten vetëm reagime kalimtare. Disa prej këtyre reflektimeve janë ndarë edhe në rrjete sociale, kryesisht në Facebook, ku kanë marrë reagime pozitive dhe kanë gjetur jehonë te lexues të ndryshëm. Megjithatë, koha dhe algoritmet e rrjeteve sociale janë të pamëshirshme: ajo që shkruhet sot, nesër humbet në rrjedhën e pafundme të postimeve dhe shpesh nuk arrin të lexohet, rilexohet apo kuptohet në thellësi.

Ky libër është një përpjekje për t'i dhënë qëndrueshmëri mendimit, për ta nxjerrë reflektimin nga përkohshmëria digjitale dhe për ta vendosur në një formë që mund të mbahet në dorë, të lexohet me qetësi dhe të dialogojë me lexuesin pa ndërmjetës.

"Unë dhe të tjerët" nuk pretendon të japë përgjigje përfundimtare. Ai thjesht hap pyetje,

parashtron mendime dhe fton lexuesin të ndalet, të mendojë dhe, ndoshta, të gjejë veten mes këtyre faqeve.

Ky libër nuk mbyllet këtu. Ai veç ndalet për një çast, ashtu si njeriu që mbështetet në prag për të marrë frymë pas një rruge të gjatë. Mendimet që janë mbledhur në këto faqe nuk janë të përfunduara, sepse as jeta nuk është e tillë. Ato janë çaste, pyetje, ndalesa të shpirtit përballë kohës ku jetojmë.

Unë dhe të tjerët është një pasqyrë që nuk kërkon të tregojë vetëm fytyrën time. Në të, secili mund të shohë veten, ose një copëz të tjetrit që ka kaluar pranë nesh pa e vënë re. Janë fjalë që u shkruan për t'u dëgjuar, për të kuptuar se sa të ngjashëm jemi në pasiguri, në frikë, në shpresë dhe në kërkimin e vazhdueshëm për të gjetur kuptimin.

Kam ardhur në këtë libër nga poezia, por nuk kam hequr dorë nga ndjeshmëria. Poezia ende më ndjek, edhe kur fjalia është më e gjatë, edhe kur mendimi është më i drejtpërdrejtë. Nëse këto faqe arrijnë të të ndalin për një moment, të të bëjnë të mendosh ndryshe, ose thjesht të ndjesh se nuk je vetëm në mendimet e tua, atëherë ky libër ka përmbushur misionin e tij. Shkrimi, në fund të fundit, nuk është veçse një mënyrë për të mos u ndjerë vetëm në këtë botë të zhurmshme dhe vetmitare në të njëjtën kohë.

E kam shkruar këtë libër me bindjen se fjalët, kur shkruhen me ndjeshmëri gjejnë gjithmonë rrugën e tyre. Edhe kur humbin në rrjete sociale, edhe kur mbesin në sirtarë, edhe kur lexohen vetëm nga një palë sy. Ato jetojnë. Dhe një ditë, ndoshta, do të gjejnë dikë që ka nevojë pikërisht për to.

Por dialogu sapo fillon.

KAPITULLI I

KUJTESË DHE FËMIJËRI

Bora e fëmijërisë

Nuk e di pse atëherë, në vitet e fëmijërisë dhe rinisë, borën e prisnim me aq gëzim të pastër, si një premtim të bardhë që binte mbi çdo pritje. Nuk kishim ngrohtësinë e ditëve të sotme, as veshje të trasha, as ngrohje në çdo cep të shtëpive, shkollave, udhëve… E megjithatë, bora na ftonte jashtë, na thërriste me magjinë e saj.

Më kujtohet ende ajo frazë e dimrave të dikurshëm: "Qafa e Qarrit është zënë." Një lajm që sillte trishtim, rrugët mbylleshin, ëndrrat për takime me të dashurit mbeteshin pezull.

Por, si fëmijë, gjithmonë besonim se bora i hapte udhët, po aq sa edhe i mbyllte, se era do të shpërndante pengesat dhe ne do të mund të shkonim atje ku zemra na thërriste.

Duart, këmbët na bëheshin akull, faqet skuqeshin nga të ftohtët, por ne vazhdonim të luanim, të shkelmonim borën e butë, të ndërtonim ëndrra në mes të bardhësisë.

Me zor na mblidhnin në shtëpi. Na thërrisnin, por neve na dukej sikur na shkëpusnin nga një botë tjetër, ajo e lirisë, e qeshjeve, e frymëmarrjeve të thella nën qiellin gri.

Brenda, pranë sobës që përvëlonte, thanim këpucët qull, pantallonat që nga gjunjët e poshtë ujë, e disa ditë më vonë, rrufa na kapte si një përqafim i ftohtë i dimrit.

E përsëri, kokëfortë, prisnim borën tjetër, atë që do të mbulonte të vjetrën, por jo kujtimet tona.

Mall e nostalgji… për vendlindjen, për fëmijërinë, për dimrat e dikurshëm që nuk kthehen më njësoj, por që jetojnë në shpirt sa herë shohim flokët e parë të borës të bien…

Dhe ja ku jam përsëri, mes bardhësisë imagjinare të kujtimeve dhe borës që bie pa pyetur për kohën që ka kaluar. Disa gjëra ndryshojnë, disa mbeten njësoj, si ai fëmija brenda nesh që ende i gëzohet flokëve të parë të borës.

Dimrat e fëmijërisë nuk kthehen më, por i mbajmë gjallë brenda nesh, si një zjarr të vogël pranë sobës së kujtimeve.

Kujtim vjeshte

Atë pasdite vjeshte, qielli dukej si grua shtatzënë që e kanë zënë dhimbjet dhe shtërzimet. Retë e zeza ngarendnin të azdisura në qiellin e zymtuar. I zymtë si vetë shpirti i asaj dite të vetmuar tetori.

Ndërsa vështroja grinë e mërzitshme të qiellit, prisja që të nesërmen të shkoja pranë prindërve për pushime. Një shoqja ime studente bënte ecejake nëpër korridorin e konviktit dhe e dëgjoja teksa bubërronte: "Prit të pushojë shiu tani këtu! Sikur po shtrydh brekët shejtani!"

Qesha me vete ndërsa e dëgjova, sepse në këtë qytet të jugut vërtet shiu ndonjëherë bie për ditë të tëra e s'di të pushojë. Shi i mërzitshëm!

Po ai, ku do të jetë vallë?!

S'e di! As në telefon s'munda të flas në postë, sepse linjat nuk punonin.

Sa kohë e shëmtuar, kohë vetëm për gjumë. Qielli duket sikur të shtyp, t'i plogështon mendimet, ta shton ankthin. Një lloj monotonie angështuese, si atëherë kur je në pritje të ndonjë shtrëngate...

Gjithë natën ra shi, përplasej aq fort pas xhamave, sikur do t'i thyente nga çasti në çast. Asgjë nuk pipëtinte nëpër korridore. Qetësi në dhomat gjysmë të boshatisura nga ikjet e shoqeve për pushime dhe stuhi jashtë. Pastaj, diku në mesnatë, u fikën edhe dritat, si për të shtuar edhe më shumë ankthin tim.

Po ti, ku je tani?!

A e di që shkova në postë dhe prita me orë të tëra?!

Ndërsa prisja korridoreve të postës, mbushur plot njerëz të stresuar nga ankthi i pritjes, m'u kujtua ajo fraza e filmit: "Vera me Mollasin të mos presë... personi nuk është paraqitur". Më bëri të vija buzën në gaz.

Pastaj mendja shkon aty pas derës, aty ku pret çanta për rrugëtimin e nesërm, ndaj dhe filloj bëj me mendje inventarin, nëse kam harruar ndonjë gjë.

Ufff! Sa natë e gjatë! Dhe shiu që s'pushon. Madje bie edhe më shumë, sikur bën garë rraskapitëse me mendimet e mia.

Më tremb kjo natë, por më shumë më tremb mungesa jote!

Ku je, pra, ku je?!

Mundohem të mbyll sytë e të fle pak, por shqetësimi se nesër më duhet të ngrihem herët për rrugë më acaron, ndërsa shiu më shpërqendron fare.

Nuk mbaj mend se si më zuri gjumi: me shiun e rrëmbyer apo me mendimin për ty?

Te nesërmen dola herët nga konvikti dhe shkova tek autobusi.

Koha ishte qetësuar, vetëm se aty-këtu uji kishte përmbytur rrugët dhe dëgjoheshin ende rënkimet e largëta të qiellit.

M'u duk sikur qielli rënkonte si lehonë e tukequr. Kishte lindur atë mëngjes të errët, kur unë kisha harruar të të kërkoja.

Në shi

Ajo ecën në shi, me hapat e saj të qetë dhe të sigurt, sikur të ishte pjesë e vetë reshjeve. Pikat e shiut bien mbi të me lehtësi, duke u përzier me frymëmarrjen e saj të ngrohtë, sikur të ishin fjalë të pathëna, të cilat shuajnë mallin që ajo mban brenda. Çdo hap që bën shihet si një ritëm i heshtur, i cili e lidh me qiellin dhe tokën, duke i lehtësuar shpirtin. Në shiun e përjetshëm, ajo gjen paqe dhe ngushëllim për atë që mungon.

Ajo ecën në shi, me hapa të qetë, ndërsa flokët e gjatë, të shkujdesur, përplasen lehtë mbi supet e saj.

Në atë çast të përkohshëm, duket sikur mendimet e saj shkrihen me melodinë e shiut, duke krijuar një harmoni të heshtur. Çdo pikë shiu që bie, i përforcon ndjenjat, duke i dhënë formë mendimeve të saj të humbura mes flladit dhe freskisë së natyrës.

Kjo mbrëmje i solli kaq trishtim, një ndjesi që depërtoi thellë në shpirtin e saj. Me duart e ftohta akull, të futura në xhepa, ajo thërrmon bisedat e fundit të lamtumirës, sikur të mund të kapte ndonjë fragment të vogël që ende nuk ka humbur. Çdo fjalë e pathënë qëndron pezull në ajrin e lagësht, duke i rënduar shpirtin, ndërsa mbrëmja zgjat, duke e përqafuar me një heshtje të trishtuar.

"Te mbetemi shokë, te mbetemi shokë, te mbetemiii…", kjo shprehje e fundit e tij i përplaset pa fund në mendje, si një tingull që nuk gjen qetësi. E torturon, sepse e di sa shumë kishte për të thënë në atë moment, sa fjalë të pathëna mbetën pezull në ajrin e asaj ndarjeje. Por ajo arriti të thoshte vetëm "Natën e mirë." Kaq mundi. Dhe ndërsa ai vështronte imazhin e saj që ngadalë shkrinte në errësirën e natës, fryma e saj doli nga goja si një tis i lehtë, duke u zhdukur në të ftohtin e heshtur të mbrëmjes.

Mëngjes tetori

Tetori është muaji i përuljes së natyrës, një moment ku gjithçka qetësohet dhe përgatitet për prehje. Në çdo fëshfërimë të erës, ndjej thirrjen e largët të dimrit, por edhe ngushëllimin që çdo fund ka një bukuri të fshehur në të. Është muaji kur koha ngadalësohet dhe ne ndalemi për të vëzhguar se si bota ndryshon para syve tanë.

Ardhsh i qetë, Tetor, me flladin tënd të ftohtë që përkëdhel natyrën, me ngjyrat e arta që shkëlqejnë në heshtje. Dhe me ditët që ngadalësohen në ritmin e erës së vjeshtës. Ti sjell me vete një paqe të ëmbël,

një premtim ndryshimi, si çdo gjethe që bie, duke përshëndetur qiellin me dorë të lehtë.

Ardhsh i butë, Tetor, nëpër shtigjet e mbuluara me fletë të zverdhura, me hapat e tu të qetë që i japin tokës një melodi të re dhe me netët që zgjasin si një pështpëritje e largët. Ti je preludi i prehjes, muaji që na mëson të pranojmë fundin, për t'u përgatitur për atë që do të pregatitet për dimër, por me qetësi e bukuri.

Ardhsh me frymëzime, Tetor! Ardhsh me frymëzime poetike për poetët ëndërrimtarë të kësaj bote, ti që sjell në çdo fëshfërimë të erës, vargje të fshehura mes gjetheve që bien. Nën qiellin e ndërrimeve të tua, mendimet fluturojnë si zogjtë që nisen për udhë,

Për poetët që shohin përtej së dukshmes, ti je udhërrëfyesi i ëndrrave të humbura dhe në qetësinë e natës, je ai që ndez yjet e mendimeve të pashprehura.

Ardhsh si një prekje e lehtë në shpirtin e çdo krijuesi, duke zgjuar ndjenjat që fshihen në thellësi, sepse çdo gjethe që bie është një histori dhe çdo puhizë e ftohtë një kujtim që pret të shkruhet.

Mëngjes dhjetori

Dhjetori mbante gjithmonë një aromë të veçantë për të.

Aromën e festave, të dimrit, borës, koncerteve me fëmijët në shkollë, dhuratën për djalin e saj, por ai mëngjes i ftohtë i vitit 1999, asaj i nuk ngjante me asnjë tjetër.

Ajo po nisej!

Do të linte pas Shqipërinë, rrugicat ku ishte rritur, zërin e prindërve, profesionin, jetën që kishte ndërtuar me aq mund… dhe më e rënda nga të gjitha, do të linte pas djalin e saj të vogël. Një copë zemre do të shkonte

me të, tjetra do të mbetej aty, në atë shtëpi ku ajo ishte rritur, ku gjeti strehë pas divorcit, ato shkallë ku ajo kishte mësuar të vraponte, këndonte, luante fëmijë e më pas në moshën e rinisë së hershme.

E ndiente se po ndahej më dysh, si një fletë letre që këputet mes duarve, gjysma e saj po nisej drejt së panjohurës dhe gjysma tjetër po mbetej aty, te djali i saj, i cili në atë moshë kuptonte vetëm një gjë: mami po shkonte shumë larg.

Proceset e ambasadave, dokumentet, pritjet e pafundme, frika se mos nuk e merrte kurrë vizën, të gjitha këto i kishte përballuar me bashkëshortin e saj pranë. Ai kishte qëndruar me të, hap pas hapi, derisa më në fund dera e ambasadës ishte hapur dhe emri i saj ishte thirrur. "Viza është miratuar."

Disa fjalë të thjeshta që ndryshuan çdo gjë.

Por ajo nuk ishte vetëm atë ditë. Bashkëshorti i rrinte afër, me atë mënyrën e tij të heshtur dhe të fortë që ia mbante shpirtin në vend. Ai kishte qëndruar me të muaj të tërë, duke pritur dokumentet, duke e marrë përdore nga ambasada e nëpër burokraci zyrash, duke mos e lënë asnjë ditë të rrëzohej prej mërzitjes dhe trishtimit. Në çdo radhë të pafund, në çdo zhgënjim, në çdo shpresë që ndizej e fikej, ai kishte qenë aty.

Ai ishte njeriu që i tha: "Ji e fortë. Do ja dalim të dy. Nuk të lë vetëm!"

Dhe ajo nuk e harroi kurrë këtë.

As sot, 26 vite më vonë, ajo nuk e harron.

Por gëzimi ishte vetëm gjysmë. Gjysma tjetër ishte trishtim i thellë. Ajo duhej të largohej pa djalin e saj të vogël. Ligjet nuk e lejonin ende ta merrte dhe ajo duhej të shkonte e vetme, me një barrë në shpirt dhe një jetë tjetër që po rritej brenda saj, një kujtim të ri që po rritej pa zë, pa u ankuar, ndërsa nëna e tij luftonte me kohën, me ligjin, me fatin.

Kur u afrua te dera, djali i saj nuk qante më.

Vetëm kishte ulur supet. Sytë i rrinin të ngrirë, të hutuar, të fiksuar tek ajo, sikur t'i lutej me shikim: "Mos ik… më merr mami, të lutem!". Ai as që kuptonte mirë çfarë po ndodhte, veç e ndiente që diçka e madhe po e largonte nënën e tij shumë, shumë larg.

Nëse do ta pyesnin, se cila ka qenë dita më e vështirë e jetës tënde, ajo pa drojë do të thoshte: ajo fytyrë e vogël, ai shikim i hutuar, ajo thirrje shpirti që vetëm ajo e kuptonte.

Ajo ditë e fundit ishte më e vështira. Djali i saj, i vogël, me supet e varura, e shikonte pa e kuptuar se çfarë po ndodhte. Ai nuk qante. Vetëm shikonte, me ata sy që dukej sikur i lutej universit: "Mos ma merr mamin, të lutem!".

Ajo iu afrua, e puthi në flokë, dhe i pëshpëriti: "Do të vij së shpejti, të premtoj!" Ajo u përpoq të buzëqeshte, t'i thoshte: "Do të vij shpejt të të marr, biri im!"

Por zëri i dridhej. Fjalët i rrëshqisnin nëpër buzë si shiu që bie duke mos dashur të lagë tokën.

Një ditë më parë, shoqja e saj e ngushtë e kishte paralajmëruar:

"Mos e kthe kokën pas kur të kalosh derën. Thonë se ndjell ters. Vetëm ec!"

Por ajo e ktheu kokën.

Mori frymë thellë, ndjeu djersë dhe lot së bashku, dhe u largua duke zbritur ato shkallë me hapa të rëndë që i dhembnin në çdo frymëmarrje.

Ajo nuk mundi.

E ktheu kokën me sytë e mbushur plot, aq plot sa nuk shihte më fytyra, vetëm silueta, vetëm lëvizje njerëzish të bashkuar me dritën e mëngjesit, të cilat nuk arrinte t'i dallonte më.

Duart i shkuan instinktivisht tek barku.

E preku lehtë, me një dhimbje që përzihej me shpresë. Brenda saj, një jetë e vogël po rritej në heshtje, një kujtim që po e merrte me vete, një jetë që ambasadat nuk e pranonin, një jetë që ligjet nuk e lejonin të udhëtonte ende.

Ajo u nis ashtu: me një valixhe të lehtë, një zemër të rëndë dhe një të ardhme të panjohur. Nuk e dinte nëse vendi ku po shkonte do ta pranonte apo do ta përndiqte, siç e kishin përjetuar kaq shumë shqiptarë emigrimin, edhe pse ajo po udhëtonte me dokumente, e rregullt.

Nuk e dinte gjuhën, nuk i dinte rrugët, nuk i njihte njerëzit aty ku do të shkonte.

Dinte vetëm një gjë:

Që po shkonte për t'u kthyer.

Për t'u kthyer një ditë dhe për të marrë djalin e saj në krahë.

Vitet kishin kaluar si faqe libri që kktheheshin vetvetiu në erë.

Ajo ishte bërë më e fortë, më e qetë, më e mençur. Kishte luftuar, kishte fituar, kishte humbur, kishte dashur… por, mbi të gjitha, kishte ndërtuar një jetë të bukur, gur pas guri, me ato duar që dikur dridheshin nga frika dhe malli.

Djali i saj tashmë ishte burrë. Jetonte pranë saj, pranë motrës së tij, pranë nënës që nuk e kishte harruar asnjë ditë. Shumë net kishte kaluar duke menduar për atë mëngjes të largët të vitit 1999, për ato shkallë që i dukeshin sikur i çanin zemrën më dysh, për sytë e djalit të vogël që nuk i largohej nga dera. Por sot, çdo plagë e vjetër dukej e largët, e shëruar.

Në krah të saj rrinte po ai njeri që dikur i kishte thënë: "Nuk të lë vetëm!". Dhe nuk e kishte lënë. Kishin kaluar 26 vite dhe ajo e dinte se çdo hap i saj, çdo frikë, çdo shpresë kishte gjetur dorën e tij pranë. Ai kishte qenë pranë saj me dashuri sa herë që ajo heshtte, duronte apo vuante. Dhe për të gjitha këto, ajo i ishte mirënjohëse.

Një mëngjes dhjetori, ndërsa drita e artë binte mbi qytetin që tashmë e quante shtëpi, ajo qëndroi pranë dritares dhe uli sytë poshtë. Për një çast, e ndjeu veten si atëherë, 26 vite më parë. Por këtë herë, asgjë nuk i dhembte. Kishte paqe. Kishte familjen. Kishte historinë e vet, të rrënjosur në zemër si një pemë që kishte mbijetuar çdo stinë.

Ajo buzëqeshi.

Sepse tashmë e dinte:

Gjithçka që kishte ëndërruar atë ditë të largët, sot ishte e gjallë, e prekshme, e vërtetë.

Dhe me një frymë të ngrohtë që i mbushi kraharorin, ajo pëshpëriti:

"Mëngjes dhjetori… pas 26 vitesh."

Ajo kishte në zemër dy atdhe!

Unë dhe bora

Bora për mua nuk ka qenë kurrë thjesht mot. Ajo ka qenë ndjesi. Kujtim. Një heshtje e bardhë që zbret nga qielli dhe mbulon gjithçka, edhe gjërat që zakonisht nuk i vë re. Unë vij nga një qytet i vogël, ku dimri ka aromë druri që digjet në oxhak dhe ku bora nuk është lajm në televizor, por diçka që e prek me dorë, që të zbardh rrugët, oborret dhe mendimet.

E mbaj mend mirë fëmijërinë time në dimër. Ishim të vegjël, por kishim një gëzim që s'e ndalte as i ftohti. Dilnim jashtë me vrap sapo shihnim flokët e parë të borës. Lojërat në borë ishin botë më vete:

topa bore që s'kishin fund, duar të skuqura, faqe të ngrira, zëra që përziheshin me të qeshura. Bënim gjurmë nëpër shtresa të bardha dhe ndiheshim sikur kishim zbuluar një vend të ri. Kishte diçka magjike në atë bardhësi, sikur gjithçka ishte bërë më e pastër, më e qetë, më e butë.

Por bora s'ishte vetëm gëzim. Kishte edhe frikë brenda saj. Frika e vogël që më lindte në mbrëmje, kur dëgjoja të rriturit të thoshin: "Po ngrin sonte… nesër do të jetë akull." Dhe unë mendoja për rrugën, për shkollën, për atë ndjesinë e rrëshqitjes që të bën të humbasësh ekuilibrin. E megjithatë, edhe ajo frikë kishte një lloj bukurie, sepse bora të mësonte të kishe kujdes, të ecje ngadalë, të vështroje ku shkel.Më pëlqen edhe sot ta shoh borën kur jam në udhëtim. Ka momente që udhëtoj dhe ajo fillon të bjerë lehtë-lehtë, pa zhurmë, si një përshëndetje e heshtur nga qielli. Flokët e saj bien mbi xhamin e makinës dhe më duket sikur ritmi i kohës koha ngadalësohet. Rruga bëhet më e qetë, më e gjatë, por edhe më e bukur. Në ato çaste nuk dua të mbërrij shpejt. Dua vetëm të jem aty, brenda atij udhëtimi, brenda asaj pamjeje.

Dhe pastaj janë mendimet… Mendimet që më vijnë kur bie borë. Kur jam brenda, pas xhamave, e shoh botën si të mbështjellë me një perde të bardhë. Gjithçka duket më larg, më e qetë. Zhurmat humbin.

Njerëzit ecin më ngadalë. Edhe unë, brenda vetes, bëhem më e heshtur. Sikur bora s'mbulon vetëm Tokën, por mbulon edhe rrëmujën e ditëve. Dhe mendimet e mia, të pështjelluara, fillojnë të rrinë më butë, më të rregulluara, më të lehta.

Bora më kujton se gjërat mund të ndryshojnë brenda një nate. Një natë më parë çdo gjë mund të ketë qenë e rrëmujshme Mbrëmë mund të jetë rrëmujë, ndërsa në mëngjes gjithçka zgjohet e bardhë dhe e qetë. Ajo vjen pa bujë, por lë gjurmë. Dhe ndoshta kjo është arsyeja pse e dua: edhe kur është e ftohtë, ajo më ngroh me kujtime.

Bora është një pjesë e imja. Është fëmijëria ime që s'dua ta harroj, është qyteti im i vogël që e mbaj me vete kudo që shkoj, është një ndjenjë që rikthehet sa herë qielli zbardh. Dhe çdo herë që bie bore, unë sërish bëhem pak fëmijë… dhe pak më e qetë.

E kuptoj sa e çuditshme është koha… si ik pa zhurmë, si merr me vete zërat, rrugët, fytyrat, edhe gëzimet e vogla që dikur na dukeshin të përjetshme. Bora i mbulon të gjitha, por nuk i zhduk. I ruan diku poshtë saj, si sekrete të bardha.

Ndoshta kjo është ajo që më bën ta dua: sepse më kujton se gjithçka kalon… por asgjë nuk humbet përgjithmonë. Sepse brenda çdo floku bore ka pak fëmijëri, pak heshtje, pak mall. Dhe unë, sa herë e shoh botën të zbardhet, e ndjej veten duke u kthyer

pas, jo për të jetuar aty, por për të mos harruar kush kam qenë.

Në fund të fundit, bora nuk është dimër…

Është nostalgji që bie ngadalë mbi shpirt.

Dita e parë e shkollës

E diel pasdite. Një ndjenjë ankthi përzier me kureshtjen fillon të zërë vend, teksa po bëhem gati për ditën e parë të shkollës. Ndoshta për herë të parë në jetën time, po përballem me të panjohurën. Çanta e shkollës është mbushur me libra të rinj që ende mbajnë aromën e letrës së freskët, lapsat janë të mprehura dhe rrobat janë zgjedhur me kujdes që nga një natë më parë.

Zgjohem më herët se zakonisht, me zemrën që më rreh shpejt. Familja më përshëndet me buzëqeshje inkurajuese, por në sytë e mi, ky është një hap i madh.

Rrugës për në shkollë, ndiej dorën e nënës që më shtrëngon lehtë, si për të më dhënë forcë. Nuk jam i vetëm, por gjithsesi ndihem i vogël përballë asaj që po më pret.

Arrijmë te porta e shkollës dhe gjithçka duket e re, e madhe, e huaj. Nxënës të tjerë, disa të qeshur, disa të tensionuar si unë, qëndrojnë pranë prindërve të tyre. Dëgjoj zërin e një mësueseje që na fton brenda. Hapat e parë në korridorin e gjatë duken të pafundmë. Pasi hyjmë në klasë, zgjedh një bankë pranë dritares, ndoshta duke kërkuar ngushëllim nga drita e diellit që hyn brenda.

Ora e parë fillon. Zëri i mësueses është i butë, por gjithsesi tërheqës, si një dorë e padukshme që të drejton. Filloj të ndjehem më i qetë, më i sigurt, ndërsa rreshtoj mbi fletë të bardhë shkronjat e para. Në fund të ditës, dal nga shkolla me një ndjenjë triumfi të vogël, sepse e di që kam kaluar një pengesë të parë, një hap të vogël, por të rëndësishëm drejt së ardhmes.

Kjo ditë e parë do të mbetet gjithmonë e ngulitur në kujtesën time, si një portë e hapur drejt një bote të re, plot me sfida, njohuri dhe përvoja të reja. Një portë që e kalova me guximin e një fëmije dhe me peshën e një momenti që do të kujtohet përjetë.

Në prag të fundit të vitit shkollor…

Ka diçka të papërshkrueshme në ajrin e qershorit.

Në oborret e shkollave, ku dikur tingëllonin zëra të vegjël e të paduruar, sot ecin fëmijë pak më të rritur, pak më të heshtur, por me dritë të re në sy. Është ajo kohë kur shohim se si, pa e kuptuar, kanë ndryshuar, jo vetëm në gjatësi apo zë, por në mënyrën si mbajnë çantën, si flasin me njëri-tjetrin, si presin… fundin.

Ka mall, ka nostalgji…

Sidomos kur sheh klasat të boshatisen ngadalë, ditarët të mbyllen për herë të fundit dhe muret të ruajnë zërat e vitit që iku.

Ka lodhje në fytyrat e mësuesve dhe nxënësve njësoj, por edhe krenari. Sepse çdo vit mbyllet me një ndjesi të vogël fitoreje.

Dhe mbi të gjitha, ka një pritje të ëmbël. Pushimet!

Fëmijët i ëndërrojnë si një liri të pakufishme, me plazh, lojëra, gjumë të vonë dhe ditë që zgjasin pafund.

E megjithatë, brenda këtij gëzimi të fëmijërisë fshihet gjithmonë një fije malli. Sepse fundi i vitit nuk është vetëm fund. Është edhe fillim. Një kapitull tjetër që pret të shkruhet, me fëmijë që, herë pas here, nuk janë më aq fëmijë si më parë.

Dikur isha unë ajo nxënësja që në qershor ndjente fundin e vitit si shpëtim, si ëndërr me pushime, liri dhe verë pa orë mësimi.

Më kujtohet ajo ndjesia kur mbylleshin librat, fletoret, ankthi i provimeve, përqafimet e shoqeve dhe më pas largoheshim nga banka e klasës me ndjenjën e lehtë si pupla, pa e kuptuar sa shumë po merrnim me vete: kujtime, mësime, emocione që do të na shoqëronin për gjithë jetën.

Sot, jam në korridore, por në një tjetër rol.

Jo më nxënëse, por pjesë e atyre që ndihmojnë, udhëzojnë, rrinë pas kuintave të çdo arritjeje të vogël. Dhe sa herë që afron fundviti, një pjesë e imja kthehet pas. I shoh fëmijët me të njëjtin gëzim që pata dikur, me të njëjtën lodhje të ëmbël, me të njëjtin mall që ende s'kanë mësuar ta emërtojnë.

E ndiej që koha ka kaluar, por ndjesitë kanë mbetur po aty, të veshura ndryshe, por po aq të forta.

Dhe kjo është një nga magjitë e bukura të të punuarit në shkollë: e jeton fëmijërinë dy herë.

Herën e parë si nxënës. Herën e dytë si i rritur që ndjek hapat e vegjël të të tjerëve… me zemrën plot kujtime.

Fundjavë

Në këtë botë të trazuar, ku hapat shpesh trokasin mbi gurë të ftohtë, shpirti dridhet nga ankthi, nga frika e një të nesërme të paqartë… Trishtimi shtrihet si mjegull, dhe dëshpërimi fsheh dritën e diellit, por ende zemra kërkon dritë, ende shpresa regëtin brenda nesh. Atëherë na duhen vargje, poezi që ringjallin frymën, muzikë që shëron plagët e padukshme, art që i jep ngjyra qiellit gri.

Na duhen njerëz pozitivë, me buzëqeshje të vërteta, miqësi që ngrohin si zjarri në dimër të acartë, familje që na duan e besojnë, dashuri që na udhëheqin dhe krahë që na mbajnë kur rrëzohemi.

Le të mbretërojë mirësia, të shndërrojë errësirën në dritë, të shuajë makthet e frikës, të na bëjë të besojmë se e nesërmja, mund të jetë ringjallje e shpresës dhe paqes. Sepse jeta, në thelbin e saj, është ëndërr e bukur, dhe kur shpirtrat bashkohen me respekt e sinqeritet, krijohet një botë ku dashuria ngadhënjen mbi dhimbjen, makthin, pasigurinë… Ku shpresa bëhet udhërrëfyes, dhe çdo çast, një ngjarje e bukur për t'u kujtuar.

Fundjavë vjeshte…

Qetësi mëngjesi, ngrohtësi çaji dhe plot ëndrra e shpresa ndër duar.

Kur kujtesa ulet për kafe

Ky bust i Ismail Kadaresë, vendosur në një nga lokalet e tij të preferuara në Tiranë, nuk është thjesht bronz e formë. Është kujtesë. Prani. Një mënyrë e heshtur për ta mbajtur mes nesh atë që i dha kaq shumë këtij vendi me mendimin, fjalën dhe shpirtin e tij.

Këtu e kam takuar edhe unë vite më parë. Nuk pati shumë bisedë, por edhe ato pak fjalë që u shkëmbyen mbetën për mua të paharrueshme. Sot, në ditën e lindjes së tij, këtij busti i është dhënë jetë. Dhe paradoksalisht, kjo "jetë" është pritur me tallje

e kritika në rrjetet sociale. Për mua, kjo nuk ka asgjë të keqe. Përkundrazi. Më duket sikur ai aty pret dhe përcjell njerëz, ashtu siç kishte zakon kohët e fundit, duke pirë kafenë me miq, me kalimtarë, me ata që donin ta shihnin nga afër. Ajo që më trishton nuk është busti, por mënyra se si disa zgjedhin të tallen. Të tallesh me një figurë që i dha identitet letërsisë shqiptare, do të thotë të tallesh me vetveten. Sepse mungesa e respektit për kujtesën, është mungesë respekti për vlerat.

Kadareja nuk ka nevojë të mbrohet nga ne. Vepra e tij flet vetë. Por ne kemi nevojë të reflektojmë: a dimë të nderojmë ata që na kanë bërë më të mëdhenj se ç'jemi? Apo do të vazhdojmë të qeshim me gjithçka që nuk e kuptojmë dot? Për mua, ai bust nuk është një objekt për t'u tallur. Është një njeri që ende rri aty. Qetë. Me dinjitet. Dhe na vështron. E njëjta gjë ndodh kudo në botë. Në Paris, shkrimtarë e poetë kanë statuja në kafenetë dhe rrugicat ku kanë shkruar. Në Londër, Dublin apo Pragë, bustet e autorëve të mëdhenj janë vende takimi, jo objekt talljeje. Askush nuk qesh me ta, përkundrazi, ndalen, ulen pranë tyre, bëjnë foto, lexojnë, reflektojnë.

Mjafton të përmendim Victor Hugo në Paris, me statuja dhe vende përkujtimore pranë hapësirave ku ka jetuar e shkruar; Honoré de Balzac, i pranishëm në rrugët e qytetit si pjesë e identitetit kulturor francez;

apo Oscar Wilde në Dublin, statuja e të cilit është kthyer në një vend takimi ku njerëzit ulen, lexojnë dhe bëjnë fotografi pa asnjë ndjesi talljeje.

Lasgush Poradeci, pranë liqenit që e deshi dhe i këndoi aq bukur me vargje.

Në Londër, Charles Dickens nderohet me statuja pranë hapësirave publike ku kalojnë mijëra njerëz çdo ditë. Në Pragë, Franz Kafka ka disa skulptura moderne e simbolike, që jo vetëm nuk janë tallur, por janë kthyer në atraksione kulturore dhe pika reflektimi.

Në të gjitha këto vende, bustet dhe statujat e shkrimtarëve nuk shihen si diçka për t'u vënë në lojë, por si pjesë e jetës urbane, si ura mes artit dhe përditshmërisë.

Bustet nuk janë për t'u tallur, por për t'u ndalur dhe për të reflektuar. Një shoqëri që di të vendosë shkrimtarët e saj mes njerëzve, di edhe t'i mbajë gjallë vlerat që ata përfaqësojnë.

Ismail Kadare nuk ka nevojë për mbrojtje, vepra e tij është më e fortë se çdo zhurmë kalimtare. Por ne kemi nevojë për kujtesë. Dhe ndonjëherë, një bust i heshtur vlen më shumë se mijëra fjalë.

Vallëzim mes reve

Edhe pse zemra më rreh fort sa herë shoh një avion, edhe pse frika më kaplon në çdo nisje, ka diçka magjike në atë çast kur rrotat ndahen nga Toka, kur qielli hap krahët dhe më fton në lartësi që i kam ëndërruar. Fluturimi është si një puthje e ëmbël e lirisë, si një vallëzim mes reve, mes pasigurisë dhe mrekullisë. Nën krahët e çeliktë që më mbajnë pezull, brenda meje lind një heshtje e thellë, një melodi pa zë që qetëson frikën dhe më kujton: je gjallë, je lart. Mbi detin Adriatik, ku dielli puth dallgët me rrezet e tij të arta, shpirti im ngrihet mbi çdo frikë, dhe zemra,

edhe pse rreh me ankth, mëson të fluturojë. Pamja shndërrohet në poezi, dhe çdo re që kalon bëhet fjalë e pathënë e një ndjenje të pastër.

Po, kam frikë nga lartësitë. Po, më dridhen duart kur dritaret hapin qiellin përpara meje. Por brenda asaj frike, jeton një guxim i butë, një ndjenjë që më shtyn të ngrihem përsëri, të sfidoj Tokën, të ndjek ëndrrat, edhe nëse më dridhet zëri. Sepse çdo zbritje më kujton ngritjen. Dhe çdo fluturim, sado i frikshëm, më jep krahë të rinj. Dhe aty, në atë çast të bukur e të trazuar, ku frika takon mrekullinë, lind një poezi, shpesh më ka ndodhur të shkruaj lartësive, me frymëzimin e shpirtit që mëson të besojë në fluturim.

Dhe shkruaj atë mall të butë që më vjen ngadalë, si puhiza e ajrit që rrëshqet mbi krahët e avionit, mall për Tokën që lashë pas, për rrugët, për njerëzit, për gjuhën që më flet ëmbël në mendje. Mall për atdheun që çdo largim e bën më të pranishëm.

Në atë lartësi, ku reja është i vetmi udhëtar tjetër, ku Toka për disa orë është thjesht një kujtim i largët, gjej një ndjenjë që s'më lë të harroj: liria nuk është mungesë frike.

Është pranimi i saj, dhe fluturimi pavarësisht saj. Është edhe një mall që flet me zemrën, e që më thotë: po kthehesh... ose po largohesh… por je gjithmonë me të në ikje e ardhje pa fund, në shtegtime që nuk matin kilometra, por ndjenja.

Frymëzim momenti

Edhe pse qielli sot është i mbuluar me re, mos harro që dielli është aty prapa tyre, gati të shkëlqejë përsëri.

Ashtu si në jetë, edhe në ditët më të vrenjtura, drita e shpresës dhe e forcës është gjithmonë brenda teje, duke pritur të shpërthejë.

Çdo re është vetëm e përkohshme, por fuqia jote për të buzëqeshur është e përhershme.

Filloje ditën me zemër të hapur dhe me besim se edhe pas shiut, ylberi gjithmonë shfaqet.

"Edhe dita më e vrenjtur ka një fund, dhe dielli do të lindë përsëri", shkruan,Victor Hugo.

“Mos harro se retë janë vetëm mysafirë kalimtarë në qiellin e pafund të shpirtit tënd”, shkruan Rumi.

“Jeta është një ekuilibër midis mbajtjes dhe lënies së lirë,

Një det i trazuar, por dhe një dritë që s’do të shuhet kurrë”, shkruan Pablo Neruda.

Ne do të zgjohemi me diellin brenda shpirtit edhe kur qielli të jetë i mbuluar me re.

Ndoshta sot qielli është gri, por shpirti yt mund të shkëlqejë me ngjyra që askush s’mund t’i shuajë.

Filloje ditën me forcën e poezisë dhe me besimin se dielli është gjithmonë aty, edhe kur nuk duket.

Prandaj, ec përpara me zemër të qetë dhe me shpirt të lehtë. Sepse edhe dita më e vrenjtur nuk mund ta fshehë dritën që ti mbart brenda vetes.

Mos harro: dielli nuk ka nevojë të duket për të ngrohur, as shpresa për të ndriçuar.

Dhe ndoshta, pikërisht sot, mes reve, do të gjesh ylberin tënd.

Edhe atëherë bëheshin hile…

M'u kujtua kjo shprehje kur pashë, për të disatën herë, një foto të dikujt që krenohej se kishte fituar një konkurs.

M'u kujtua vetja, e re, gjimnaziste, e etur për letërsinë.

Merrja pjesë në atë konkurs me gjithë shpirt, sepse dashuria për librat ishte e vërtetë, e pastër.

Lexoja shumë, ëndërroja shumë.

Dola në finale, por nuk fitova.

Jo sepse nuk isha e denjë, por sepse përgjegjësi i bibliotekës e kishte shitur pyetjen "enigmë" tek dikush tjetër, tek "fituesi" i parashikuar.

I lidhnin miqësitë dje, i lidhin miqësitë sot, aq sa fjalën e keqe prej provinciali, e thonë shumë kollaj, vetëm të duken të parët.

Po, po… edhe atëherë funksiononin këto.

E kujtoj atë moment dhe buzëqesh.

Jo me hidhërim, por me gëzim që nuk isha pjesë e asaj loje.

Që nuk u theva, nuk u bëra si ata.

Nuk u pajtova me hilen.

Rruga ime më pas ishte e gjatë. Vazhdoja përpara me pasion, ndoqa studimet për gjuhë e letërsi dhe tregova me vepra se lidhja ime me poezinë e fjalën nuk ishte e rastësishme, por një udhëtim shumë më i hershëm se "fituesi i konkursit", më i gjatë e i bukur.

Dhe kur kthej kokën pas, e di me siguri: gjithçka filloi nga ai moment.

Krenaria ime nuk është një konkurs i shitur në vendlindje.

Krenaria ime është rruga që kam ecur, faqet e lexuara, vargjet e shkruara, pasioni që nuk u shua kurrë. Dhe kjo është fitorja më e madhe.

Pse fëmijët vizatojnë gjithmonë të rriturit me një zemër?

Ndoshta sepse zemra është gjuha e tyre më e thjeshtë dhe më e pastër.

Një fëmijë nuk e njeh ende logjikën e ftohtë të të rriturve, as simbolikat e ndërlikuara të artit. Ai njeh dashurinë, sigurinë dhe përqafimin. Prandaj, sa herë që vizaton nënën, babain, mësuesen apo dikë që e do, zemra është aty, një shenjë e vogël që thotë shumë.

Edhe vetë vizatimet e tyre janë zemra më vete. Me ngjyra të forta, me figura të thjeshta, por të mbushura me jetë. Në çdo vijë të shtrembër e në çdo ngjyrë të

papërsosur fshihet një ndjenjë e vërtetë. Për ta, arti nuk është bukuri e rregullt, por shprehje e shpirtit.

Prandaj fëmijët vizatojnë me zemër, sepse është mënyra e tyre për të treguar dashurinë, mirënjohjen dhe lidhjen me ata që u japin siguri. Zemra në vizatimet e tyre nuk është thjesht simbol, është mesazhi më i pastër i botës së brendshme që ende nuk e kanë mësuar ta fshehin.

Kur një fëmijë të dhuron një vizatim, në të vërtetë ai nuk të ka dhënë thjesht disa ngjyra në letër.

Një jetë mes fëmijëve,
një profesion me shpirt

Për shumë vite me radhë, profesioni i mësueses ka qenë për mua më shumë se një detyrë apo një rol shoqëror. Ka qenë një mision, një mënyrë jetese, një marrëdhënie e përditshme me shpirtin e fëmijëve. E kam ushtruar këtë profesion me përkushtim, me dashuri dhe me përgjegjësi, duke e ndjerë çdo ditë peshën dhe bukurinë e tij.

Në Shqipëri kam qenë mësuese e gjuhës dhe letërsisë, ndërsa në Francë vazhdova ta ushtroj këtë profesion me të njëjtin seriozitet, kujdes dhe pasion

për 22 vite me radhë. Dy vende, dy realitete të ndryshme, por e njëjta dashuri për fëmijët dhe për dijen.

Gjatë gjithë këtij rrugëtimi kam marrë shumë dashuri dhe respekt, si nga prindërit, ashtu edhe nga nxënësit. Kam përjetuar një ngazëllim të thellë shpirtëror nga ky profesion, edhe pse jo çdo ditë ka qenë e lehtë. Puna me fëmijët kërkon durim, energji, përkushtim dhe një prani të vazhdueshme emocionale. Pikërisht kjo punë më ka mësuar durimin, më ka mësuar të jem e vëmendshme, të dëgjoj, të kuptoj dhe të jem pranë tyre në çdo moment.

Në çdo çast përballë fëmijëve ka pasur momente vëmendjeje të thellë, çaste kureshtjeje, pyetje të pafundme dhe sy që kërkonin siguri. Një shprehje thotë se kur një fëmijë të dhuron një vizatim, ai të dhuron shpirtin e tij. Unë kam marrë shumë dhurata të tilla: vizatime me zemra, me lule, me figura ku shpesh isha unë e vizatuar nga duart e tyre të vogla. Kam marrë lule dhe dhurata në fund të viteve shkollore, por mbi të gjitha kam marrë dashuri të sinqertë dhe kujtime që nuk do të zbehen kurrë.

Vjen një moment në jetë kur ndodhemi në udhëkryqe vendimesh, si për profesionin, ashtu edhe për shëndetin. Puna me fëmijët kërkon shumë

dinamizëm, forcë dhe prani të vazhdueshme fizike e emocionale. Vjen një çast kur zgjedhim një rrugë tjetër, por kjo nuk do të thotë se ajo që kemi jetuar humbet. Përkundrazi, puna me fëmijët mbetet një nga përvojat më të bukura dhe më të paharruara të jetës sime.

Çdo moment me ta ka vlerë. Çdo kohë e kaluar me ta ka kuptim. Çdo bisedë, çdo e qeshur, çdo moment trishtimi kur prindërit largohen dhe ata, të përlotur, kërkojnë mbështetje dhe siguri tek krahët e tu, të gjitha vlejnë. Sepse unë isha aty për ta, gjithmonë e disponueshme, e gatshme të jap ngrohtësi, qetësi dhe siguri.

Do të më mungojnë oborret e shkollës, zhurmat e fëmijëve, zënkat e vogla mes tyre që shpesh përfundonin në pajtim e miqësi. Do të më mungojnë shqetësimet që sillnin nga familjet e tyre dhe besimi i madh me të cilin më hapnin zemrën, duke më bërë pjesë të botës së tyre. Do të më mungojnë gjunjët e vegjël të gërvishtur, kur vinin për t'u mjekuar me besim të plotë, sikur kraharori yt ishte vendi më i sigurt në botë.

Edhe pse sot zgjedh një rrugë tjetër, mësuesia mbetet pjesë e imja dhe e zemrës sime. Ky profesion nuk matet me vite pune, por me dashurinë, durimin dhe gjurmët që lë në jetët e fëmijëve. Mësuesit janë ata që mbjellin fjalë, vlera dhe besim, edhe kur nuk

e dinë se kur do t'i shohin frytet. Dhe pikërisht për këtë, mësuesia mbetet një nga profesionet më fisnike që ndërton njerëz, me përkushtim, heshtje dhe shumë dashuri.

Nuk ka fëmijë të vështirë

Nuk ka fëmijë të vështirë. E vështirë është të jesh sot fëmijë në një botë ku të rriturit janë të lodhur, të preokupuar, të paduruar dhe të nxituar!

Fëmijët e sotëm: Pasqyrë e një bote të lodhur!

Nuk ekzistojnë fëmijë të vështirë!

Çdo fëmijë lind me një dritë të brendshme, me kureshtje, ëndrra dhe një dëshirë natyrore për të mësuar e për të dashur.

Por sa lehtë shuhet kjo dritë në një botë ku të rriturit janë të lodhur nga përditshmëria, të preokupuar me sfida ekonomike, të paduruar për rezultate të shpejta

dhe gjithmonë të nxituar drejt një destinacioni që as vetë nuk e kuptojnë.

Të jesh fëmijë sot, do të thotë të rritesh në një realitet ku koha për lojë është zëvendësuar me ekranet, bisedat me prindërit janë shkurtuar në mesazhe të shpejta, dhe vëmendja e të rriturve shpesh është e përqendruar tek streset e përditshme.

Fëmijët kërkojnë thjesht një vesh të dëgjojë, një dorë që i mbështet dhe një zemër që i mirëkupton.

Shpesh, sjelljet që i quajmë "të vështira", janë vetëm pasqyra e një mjedisi që nuk u jep atyre hapësirën për të qenë vetvetja.

Një fëmijë që ndjehet i dëgjuar dhe i kuptuar, përparon.

Ndërsa një fëmijë që ndjehet i shpërfillur apo i ngarkuar me pritshmëri të tepërta, shpesh shfaq frustrime që ne i keqinterpretojmë.

Është koha të ndalemi dhe të reflektojmë:

A po i dëgjojmë vërtet fëmijët tanë?

A po ju japim atyre kohën dhe vëmendjen që meritojnë?

Fëmijët nuk kërkojnë prindër perfektë, por prindër të pranishëm dhe ata

janë pasqyra më e pastër e shoqërisë që ndërtojmë. Duke u dhënë atyre kohë, vëmendje dhe dashuri, ne jo vetëm që i ndihmojmë të rriten të lumtur dhe të sigurt, por gjithashtu krijojmë një të ardhme më të ndritur për të gjithë.

Siç thotë një thënie e urtë: “Që të jeni në kujtimet e fëmijëve tuaj nesër, duhet të jeni në jetën e tyre sot.”

Le të bëhemi prindër të pranishëm dhe të kujdesshëm, duke u ofruar fëmijëve tanë një fëmijëri të mbushur me kujtime të bukura dhe mësime të vlefshme, që ata të mund të rriten në individë të dashur dhe të përgjegjshëm.